



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

PROPOZIM

RREGULLORE
PËR TRANSPARENCËN NË KOMUNËN E LIPJANIT

Lipjan, 2021

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës propozon:

Në mbështetje të neneve 12 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit Nr.06/L-081 për qasje në dokumente publike i datës 30 maj 2019, Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në Komuna, neneve 20, 63, 64 dhe 65 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës _____ të miratojë këtë :

PROPOZIM

RREGULLORE PËR TRANSPARENCË NË KOMUNËN E LIPJANIT

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është:

1.1. Forcimi i transparencës në punë të organeve të Komunës: Kuvendit të Komunës dhe Kryetarit të Komunës, organeve të Administratës: drejtorateve komunale, institucioneve arsimore dhe shëndetësore, punës së ndërmarrjeve publike lokale dhe rritjes së pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje në nivel lokal.

1.2. Të krijoj rregullat që mundësojnë ushtrimin sa më të lehtë të kësaj të drejte.

1.3. Të nxitë praktika të mira administrative për qasje në dokumente zyrtare.

Neni 2 Fushëveprimi

Kjo Rregullore, rregullon pjesëmarrjen e publikut në mbledhjet e Kuvendit të komunës dhe komiteteve të tij, mbledhjet e publikut, obligimin për njoftim publik, konsultimi i akteve komunale dhe publikimi i tyre, pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje, qasja e publikut në dokumentet zyrtare të komunës si dhe transparenca në prokurimin publik.

Neni 3 Përkufizimet

1. Përkufizimet e kësaj Rregulloreje janë:

- 1.1. **"Seancat e Kuvendit Komunal"**- Janë mbledhjet e rregullta dhe të jashtëzakonshme të anëtarëve të Kuvendit të Komunës.
- 1.2. **"Komitetet"**- Janë trupa të zgjedhur nga Kuvendi i komunës.
- 1.3. **"Pjesëmarrja e publikut"**- Do të thotë angazhimi i qytetarëve në vendimmarrje të organeve të pushtetit lokal.
- 1.4. **"Njoftimi i publikut"**- Do të thotë afishimi i njoftimeve në tabelën e shpalljeve në ndërtesën e Kuvendit të komunës, publikimin e tyre në media lokale dhe internet për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, të komiteteve, të organeve administrative, të institucioneve arsimore, shëndetësore dhe ndërmarrjeve publike lokale.
- 1.5. **"Tubimet publike"**- Janë tubime të organizuara nga organet e komunës me qëllim të njoftimit të qytetarëve me punën e organeve të komunës dhe ngritjen e çështjeve të ndryshme nga qytetarët.
- 1.6. **"Peticionet"**- Janë kërkesa kolektive me shkrim që i adresohen komunës respektivisht Kuvendit të komunës, nga një grup i interesit apo organizata, rreth së cilës çdo çështje që ka të bëjë me përgjegjësitë e komunës me qëllim që ajo të ndërmarrë ndonjë veprim ose përmbahet nga ndonjë veprim.
- 1.7. **"Konsultimi publik i akteve komunale"**- Nënkupton pjesëmarrjen e qytetarëve dhe palëve të interesuara në procesin e vendimmarrjes me qëllim të marrjes së opinioneve, sugjerimeve, kërkesave dhe vërejtjeve të tyre gjatë zhvillimit të procedurave të hartimit të politikave, dokumenteve strategjike dhe akteve nënligjore të kuvendit të komunës.
- 1.8. **"Qasja në dokumentet zyrtare"**- Nënkupton shikimin e dokumenteve zyrtare të komunës në pajtim me Ligjin për qasje në Dokumentet Zyrtare Publike.
- 1.9. **"Plani i veprimit"** – Nënkupton hartimin e një plani operacional të Kryetarit të komunës dhe të Kuvendit.
- 1.10. **"Prokurimi Publik"**- Janë rregulla dhe procedura të përcaktuara në bazë të Ligjit për Prokurimin Publik, për të lidhur kontratë ndërmjet Autoritetit kontraktues (Komunës) dhe Operatorëve Ekonomik, qoftë për furnizim, shërbim apo punë.
- 1.11. **"Transparencë"**- është veprimtari e hapur e organeve të komunës që i siguron publikut dhe palëve të interesuara mundësinë e pjesëmarrjes në procesin vendimmarrës.
- 1.12. **"Dokument publik dhe dokument zyrtar"**- ka kuptimin e përkufizimit ashtu siç është e përcaktuar me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike.
- 1.13. **"Kërkues i dokumentit"**- çdo person fizik apo juridik, pa diskriminim në çfarëdo lloji baze, në mënyrë dhe nën kushtet të përcaktuara me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike.

- 1.14. **"Akt normativ i komunës"**- nënkupton aktin normativ që nxirret nga organet kompetente të komunës në bazë të kompetencave të dhëna nga ligji për vetëqeverisje lokale dhe ligjeve tjera në fuqi, që nxirren nga organet komunale dhe kanë zbatim brenda territorit të komunës së Lipjanit.
- 1.15. **"Palët e interesuar"**- nënkupton çdo person fizik juridik, organizatë e shoqërisë civile, grupe të ndryshme të interesit si dhe grupe të tjera që ndikohen drejtpërdrejt apo tërthorazi në procesin e vendimmarrjes.
- 1.16. **Propozues i akteve nënligjore të komunës dhe politikave lokale** – nënkupton: kryetarin e komunës, drejtoritë komunale, kryesuesin e kuvendit të komunës, komitetet e kuvendit të komunës, pesëmbëdhjetë për qind (15%) e qytetarëve të komunës përkatëse me të drejtë vote.
- 1.17. **Grupi punues** – është ekipi përgjegjës për hartimin e projekt propozimit, i caktuar nga organi kompetent komunal përgjegjës për hartimin e projekt-propozimit.
- 1.18. **Zyrtari përgjegjës për përgatitjen e draftit fillestar të projekt propozimit** – nënkupton nëpunësin civil përgjegjës për përgatitjen e projekt-propozimit i caktuar nga organi kompetent i komunës apo drejtoria/njësia përkatëse që është përgjegjëse për hartimin e projekt-propozimit.
- 1.19. **Zyrtari përgjegjës për konsultim publik** – nënkupton njësinë/zyrtarin për komunikim publik në komunë i cili është përgjegjës për koordinimin e procesit të konsultimit publik.
- 1.20. **Projekt-propozim** - nënkupton të gjitha dokumentet që i nënshtrohen procesit të konsultimit publik para aprovimit të tyre.
- 1.21. **Agjencia-nënkupton Agjencinë** - për Informim dhe Privatësi, të themeluar në bazë të Ligjit të veçantë për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 4

Mbledhjet e Kuvendit të Komunës

1. Mbledhjet e Kuvendit të komunës janë të hapura për publikun dhe përfaqësuesit e mjeteve të informimit publik.
2. Komuna përmes faqës zyrtare transmeton mbledhjet e Kuvendëve Komunale, duke përdorur pajisjet e nevojshme për transmetim. Po ashtu Komuna përveç informimit për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit dhe Komiteteve duhet t'i njoftoj vazhdimisht qytetarët që kanë të drejtë të jenë pjesë e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.
3. Kuvendi i komunës nëpërmjet zyrës përgjegjëse për informim njofton publikun të paktën 7 (shtatë ditë), para mbledhjeve të rregullta ose 3 (tre ditë), para mbledhjeve të jashtëzakonshme.
4. Njoftimi publik bëhet përmes:
 - 4.1. Shpalljes publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës,
 - 4.2. Mediave të shkruara dhe elektronike lokale,
 - 4.3. Ueb faqes së komunës dhe rrjeteve sociale.

5. Njoftimi me shkrim për publikun përmban:

- 5.1. Datën e mbajtjes së mbledhjes,
- 5.2. Kohën e mbajtjes së mbledhjes,
- 5.3. Vendin e mbajtjes së mbledhjes,
- 5.4. Rendin e ditës të caktuar për atë mbledhje.

6. Mbledhjet e Kuvendit të komunës mund të jenë të mbyllura pjesërisht ose tërësisht vetëm për shkaqet e parashikuara me ligjin në fuqi. Në këto raste, me vendim të arsyetuar, Kuvendi komunal i shpallë mbledhjet pjesërisht ose tërësisht të mbyllura për publikun.

7. Të gjitha aktet normative të Kuvendit të komunës, duhet të bëhen publike, si vijon:

- 7.1. Fages zyrtare elektronike të komunës
- 7.2. Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës (për aktet e parapara me dispozitat e ligjslacionit në fuqi)
- 7.3. Mediave të shkruara dhe elektronike,

8. Buxheti komunës dhe planet e komunës janë dokumente publike. Komuna merr masa për t'i vënë në dispozicion të publikut, mjeteve të informimit dhe grupeve të interesit për çështjen që është objekt i diskutimit sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 5

Mbledhjet e Komiteteve të Kuvendit

1. Mbledhjet e komiteteve të Kuvendit Komunal janë të hapura për publikun, përfaqësuesit e mjeteve të informimit dhe grupeve të interesit për çështjen që është objekt diskutimi sipas legjislacionit në fuqi.
2. Komitetet nëpërmjet zyrës përgjegjëse për informim njoftojnë publikun 7 (shtat ditë), para ditës së caktuar për mbajtjen e mbledhjeve. Njoftimi për publik duhet të përmbajë: datën e mbledhjes, kohën e mbledhjes, vendin e mbledhjes dhe rendin e ditës.
3. Të gjitha vendimet e komiteteve, publikimi i të cilave nuk kufizohet nga legjislacioni në fuqi për qasjen në dokumentet zyrtare publike, duhet t'i vihen në dispozicion publikut sipas kërkesës.
4. Komiteti mund të organizojë dëgjime publike me qytetarë dhe grupe të interesit për çështjet me të cilat merret komiteti përkatës.

Neni 6

Transparenca e akteve të organeve të Komunës

1. Publikimi në faqen zyrtare të komunës i akteve normative të komunës me karakter të përgjithshëm është i obligueshëm.
2. Të gjitha aktet e Kryetarit të Komunës që ndikojnë drejtëpërdrejt në interesat e qytetarëve pas hyrjes në fuqi duhet të publikohen në faqen zyrtare të komunës.
3. Aktet normative dhe vendimet e organeve të komunës dërgohen në Sektorin për Mardhënie me Publikun për publikim dhe të cilat duhet të publikohen në faqen

zyrtare të komunës, në gjuhët zyrtare dhe në formatin e përcaktuar nga Sektorin për Mardhënie me Publikun.

4. Me qëllim që qytetarët të jenë të informuar për vendimarrjen e organeve komunale, komuna duhet t'i shfrytëzojë mundësitë e informimit që qytetarët t'i njoftojë për përmbajtjen e çdo akti të miratuar që është interes të përgjithshëm.

Neni 7

Transparenca Financiare

1. Komuna obligohet në transparencë të planifikimeve dhe shpenzimeve buxhetore duke ndërmarrë veprime konkrete në publikimin e tyre në faqen zyrtare të komunës:

- 1.1. Plani i buxhetit pas aprovimit në Kuvendin e Komunës dhe vlerësimin e ligjshmërisë nga organi mbikëqyrës,
- 1.2. Raportet tremujore financiare sipas afateve të parashikuara me legjislacionin sektorial,
- 1.3. Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) pas aprovimit në Kuvendin e Komunës dhe vlerësimin e ligjshmërisë nga organi mbikëqyrës,
- 1.4. Raporti përmbledhës financiar për vitin e kaluar fiskal sipas afateve të parashikuara me legjislacionin sektorial,
- 1.5. Publikim i raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Neni 8

Transparenca në aktivitete e prokurimit

1. Komuna publikon në faqen zyrtare elektronike çdo aktivitet të prokurimit, publikimi i të cilave është i përcaktuar me legjislacionin sektorial.
2. Komuna publikon planin dhe raportin e prokurimit në faqen zyrtare elektronike, ashtu siç përcaktohet me legjislacionin sektorial.

Neni 9

Qasja e drejtëpërdrejtë në dokumente publike

1. Komuna siguron qasje në dokumente publike përmes faqes zyrtare si :
 - 1.1. Planin e punës së kryetari dhe kuvendit të komunës,
 - 1.2. Strategjitë dhe dokumentet e tejra të politikave të miratuara,
 - 1.3. Planin Zhvillimor Komunal, Hartat zonale dhe planet rregulluese urbane,
 - 1.4. Raportin vjetor të punës së kryetarit dhe kuvendit,
 - 1.5. Procesverbalet e takimit të kuvendit të komunës dhe komiteteve obligative,
 - 1.6. Të dhënat për biografitë e udhëheqësve të lartë të organeve të komunës,
 - 1.7. Emrin, numrin e telefonit zyrtar dhe adresën e emailit të drejtuesve të njësive brenda institucionit,

1.8. Listën e hollësishme të shërbimeve që ofron institucioni për publikun si: licenca, leje, autorizime, certifikata, vërtetime apo shërbime tjera ku do të përfshihen edhe:

1.8.1. Procedura dhe kushtet e përfitimit të tyre,

1.8.2. Afati i detyrueshëm për të marrë përgjigje për shërbime kërkuar.

Neni 10

Kërkesat për informim, iniciativat qytetare dhe petitionet

1. Çdo subjekt fizik dhe juridik ka të drejtë të parashtrojë kërkesë për realizimin e ndonjë të drejte, iniciative qytetare dhe petition, për çështje që janë përgjegjëse organet e komunës.

2. Qytetarët mundë të marrin iniciativë për të propozuar rregullore, brenda kompetencave të komunës, për miratim nga kuvendi apo me votën e qytetarëve, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

3. Çdo person apo organizatë me interes në komunë ka të drejtën e prezantimit të petitionit në kuvendin e komunës për çfardo çështje lidhur me përgjegjësitë dhe kompetencat e komunës. Kuvendi i komunës shqyrton petitionin në pajtim me statutin dhe rregullorën e punës.

3.1. Subjektet e përmendura më lart mund t'i drejtojnë petitionin Kuvendit të Komunës për çështjet që janë në kompetencën e tij në mënyrë të pakufizuar, e që kanë të bëjnë me :

3.1.1 rregullimin e qytetit,

3.1.2 mirëmbajtjen e rendit dhe të infrastrukturës,

3.1.3 urbanizmin e qytetit dhe fshatit,

3.1.4 mirëmbajtjen e mjedisit jetësor,

3.1.5 zbatimin e vetëkontrollit dhe

3.1.6 çështje të tjera të rëndësishme për jetën e popullatës vendore.

4. Kërkesat iniciativat qytetare dhe petitionet shqyrtohen nga Kuvendi i Komunës brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh siç është e përcaktuar në nenin 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale.

5. Pas diskutimit në Kuvendin e Komunës Kryetari i Komunës ose shërbimet përkatëse, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e shqyrtimit njofton me shkrim parashtruesin e kërkesës ose petitionit.

6. Në raste kur kërkesa për realizimin e ndonjë të drejte, iniciative qytetare ose petitioni, lidhen me çështje për të cilat komuna nuk është drejtpërdrejt kompetente, Kryetari i komunës ose shërbimi përkatës, brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 4 të këtij neni, njofton me shkrim parashtruesin e kërkesës ose petitionit se është jo kompetente, si dhe procedon atë tek organet kompetente duke njoftuar parashtruesin e kërkesës.

2. Me hyrjen në fuqi të kesaj Rregullore, shfuqizohet Rregullorja mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr. 15-000-79233, e datës 20.12.2020.

Neni 19 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare elektronike të komunës.

Arsyetim

Baza ligjore për të miratuar këtë Propozim Rregullore është përcaktuar në mbështetje të neneve 12 dhe 68 par. 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit Nr.06/L-081 për qasje në dokumente publike i datës 30 maj 2019, Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna, Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në Komuna si dhe neneve 20, 63, 64 dhe 65 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008.

Në pajtim me dispozitat e cekura ligjore kërkojmë nga Kuvendi i komunës miratimin e kësaj Propozim-Regulloreje.

1Nr. 030-32849
Lipjan, më 17.06.21

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

